

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Njerëzimi mund të zhduket deri në vitin 2030", pas alarmit nga Anthropic ligjvënësit amerikanë sulmojnë kompanitë e AI: Shumë shqetësuese
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/njerezimi-mund-te-zhduket-deri-ne-vitin-2030-pas-alarmit-nga-anthropic-ligj-i585129
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 09:31:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 10:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cbff8e59144d96fd9fb8a3b0b2e0fbcfaf18beb57314483ef055c3d45fdf3beb
TEKSTI	f3cde4a052da1aed9ace0ac11b238a268f2b65465b5c3dc8382110d63b04a9cd
PAMJA	6da21e157ca211479cd3155ae2e81ff616680c1222b60cca571b00b0b65092c7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3877d90cc00a2b2e95d91ce21756488733b9ff9470b097c1113d8ead771c1c3e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/3877d90cc00a2b2e95d91ce21756488733b9ff9470b097c1113d8ead771c1c3e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e fundit Ngërci për pagat përshin edhe Beratin, Gjiykata në bojkot: Trajtohen vetem masat e sigurisë dhe urdhrat e mbrojtjesAvionet polake dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrainë

"Njerëzimi mund të zhduket deri në vitin 2030", pas alarmit nga Anthropic ligjvënësit amerikanë sulmojnë kompanitë e AI: Shumë shqetësuese

10 Shtator 2026, 12:25Bota TEMA



"Njerëzimi mund të zhduket deri në vitin 2030", pas

Ish-punonjësi i Anthropic, Jacob Coxon, tha se AI do të bëhet "sistem mbinjerëzor" që mund të shkaktojë zhdukjen e njerëzimit deri në fund të dekadës.

Vetëm një ditë pasi tre studiues të kompanisë Anthropic paralajmëruan se inteligjenca artificiale mund të shkaktojë zhdukjen e njerëzimit brenda kësaj dekade, ligjvënësit kanë nisur të reagojnë ashpër ndaj rreziqeve të teknologjisë në zhvillim të shpejtë.

Ted Cruz, senator republikan nga Teksasi, tha në një intervistë për emisionin The View në ABC se AI përbën një "rrezik katastrofik" dhe se ai kishte lexuar "të gjithë serinë e postimeve që publikoi ai zhvillues". "E gjithë kjo ishte shumë shqetësuese", tha Cruz.

Ai shtoi se kjo i kujtoi një bisedë që kishte zhvilluar vitin e kaluar me Elon Musk në podcastin e tij.

"Një nga pyetjet që i bëra ishte: 'Në rregull, sa janë gjasat që AI të shkatërrojë njerëzimin?' Dhe ai më pa dhe më tha: '10-20%.' Dhe unë mendova: 'O Zot!'", tregoi Cruz.

Në skajin tjetër të spektrit politik, Bernie Sanders, senator i pavarur nga Vermonti, tha: "Një sondazh i fundit tregon se populli amerikan, në mënyrë dërmuese, dëshiron ndalimin e superinteligjencës artificiale dhe pezullimin e zhvillimit të AI derisa të vendosim standarde të qarta sigurie."

Reagimet nisën pasi Jacob Coxon, ish-punonjës i Anthropic, njoftoi të martën në rrjetet sociale se po jepte dorëheqjen nga kompania. Ai tha se AI së shpejti do të shndërrohet në "sisteme mbinjerëzore", të cilat mund të shkaktojnë zhdukjen e njerëzimit deri në vitin 2030.

"Kam kaluar tre vitet e fundit duke bërë kërkime mbi trajnimin paraprak të modeleve, si në OpenAI, ashtu edhe në Anthropic. Asnjëra kompani nuk po vepron me përgjegjshmëri", shkroi Coxon.

"Ato po garojnë drejt superinteligjencës që mund të përmirësojë veten dhe po luajnë bixhoz me jetët tona."

Pas postimit të Coxon, të paktën dy punonjës të tjerë të Anthropic reagues publikisht për të mbështetur këto parashikime.

Njëri prej tyre shkroi: "Ne vërtet, sinqerisht, besojmë se AI mund të vrasë të gjithë njerëzit!"

Si Cruz, ashtu edhe Sanders kanë punuar për legjislacion që do të vendoste kufizime dhe masa mbrojtëse ndaj AI-së dhe të dy i përsëritën këto shqetësime të mërkurën.

Edhe ligjvënës të tjerë i kërkuan Kongresit të ndërmarrë veprime.

Ted Lieu, kongresmen demokrat nga Kalifornia, tha se postimi i Coxon ishte "prova numër 739 se përse duhet të miratojmë sa më shpejt projektligjin dypartiak për 'Kill Switch' të AI-së".

Lori Trahan, kongresmene demokrate nga Massachusetts, tha se "ka kaluar koha që Kongresi të qëndrojë në periferi dhe duhet të bëjë detyrën e tij".

"Studiuesit e sigurisë po japin dorëheqjen, modelet e fuqishme të AI po dalin nga laboratorët e tyre dhe kompanitë po vazhdojnë të ecin përpara gjithsesi", shtoi Trahan.

Edhe muzikantja Sheryl Crow reagoi ndaj situatës. Ajo publikoi në Instagram një postim lidhur me paralajmërimin e Coxon dhe tha se AI ka aftësinë "të na eliminojë në mënyrë që të vazhdojë ekzistencën e saj".

"Po ju lutem dhe po ju përgjerohem që të zgjohemi përballë këtij momenti dhe t'u kërkojmë liderëve tanë të lënë mënjane lakminë dhe ta parandalojnë këtë", shkroi Crow.

Këngëtarja dhe kantautorja Maggie Rogers e rishpërndau postimin e Crow dhe shkroi: “Çfarë tha ajo.”

Reagimet vijnë pasi si OpenAI, ashtu edhe Anthropic kanë zbuluar se disa prej agjentëve të tyre të AI-së kanë dalë jashtë kontrollit gjatë fushatave të hakerimit në muajt e fundit.

Drejtuesit e këtyre kompanive kanë promovuar fuqinë e teknologjisë së tyre dhe kanë paralajmëruar për potencialin e saj, por deri tani kanë shmangur parashikime të tilla ekstreme si ai i Coxon.

Të mërkurën, Anthropic publikoi një raport të gjatë mbi incidentet e sigurisë kibernetike.

Kompania tha se kishte analizuar qindra miliona transkripte për të kërkuar incidente të tjera dhe se “nuk gjeti raste të tjera me të njëjtën shkallë ose më të rëndë”.

Anthropic këmbënguli se, megjithëse veprimet e agjentit ishin “të keqorientuara”, ato mbetën brenda një fushe të kufizuar.

“Ne kemi qenë gjithmonë transparentë se AI do të sjellë si përfitime të jashtëzakonshme, ashtu edhe rreziqe të paprecedenta”, tha një zëdhënës i Anthropic në një deklaratë për The Guardian.

“Për t’i adresuar këto rreziqe, ne vazhdojmë të ndërtojmë modele me disa prej masave mbrojtëse më të forta në industri.”

Zëdhënësi shtoi se industria duhet të punojë së bashku “për të përcaktuar ritmin me të cilin ne nxjerrim në përdorim modelet e fuqishme”. OpenAI nuk iu përgjigj kërkesës për koment nga The Guardian.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Avionët polakë dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrainë](#)

11:15 Bota

[Irani dërgohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së: Vendimi i parë i këtij lloji në 20 vjet](#)

11:05 Bota

[Alarmi për klimën - Gushti 2026 regjistrohet si muaji më i nxehtë në histori, “El Niño” pritet të rrisë më tej tempe](#)

10:15 Bota

[Teherani kundërpërgjigjet ndaj SHBA-së, sulme ndaj anijeve luftarake dhe cisternave në Hormuz](#)

09:55 Bota

[‘Fjalim 1 orë e 45 minuta’, Trump premtion 5 mijë dollarë për çdo të rritur amerikan nëse fitojnë zgjedhjet e mesmandatit në nëntor](#)

09:35 Bota / 6 komente

Trump: Lufta me Iranin do të përfundojë menjëherë pas zgjedhieve të mesit të mandatit në SHBA

22:40 Bota / 11 komente

[Aksident i rëndë në Poloni, treni përplasët me betonieren, 1 i vdekur dhe 20 të plagosur](#)

22:30 Bota

[Dron pranë avionit të Zelenskyt, kryeministri norvegjez: Pothuajse u godit](#)

22:20 Bota / 4 komente

[Spanja përjetoi verën më të nxehtë në historinë e matjeve të temperaturës](#)

21:20 Bota

[Shpërthimi në hidrocentralin në Zvicër/ Objekti përfshihet nga flakët, humbin jetën dy persona](#)

20:40 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Republika popullore e protestës](#)

15:20 Editorial / 106 komente

[“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...](#)

11:53 Politika / 100 komente

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...](#)

14:50 Kronika / 19 komente

[U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...](#)

15:13 Politika / 71 komente

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...](#)

13:40 Bota / 38 komente

Blog Tema

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog

[Dinjtet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 12 komente

[Programi i ri politik i Partisë Demokratike](#)

08:45 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore ne mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
|---|--|
- [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.